



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rr. "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;

Dhe

"V-SHALA" Shpk, nga Barani Komuna e Pejës, të cilat i përfaqëson z. Sadri Shala Nr. Unik Rexh. Biznesi, 810198384 perkatesisht, vazhdim "Kontraktuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë të shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

RREGULLIMI I TROTUARËVE NË VRELLË - Lot 2

<i>Nr. I prokurimit</i>	<i>633-20-2740-5-2-1/ C 348 lot 2</i>
<i>Nr. I brendshëm</i>	<i>633 / 020 / 033 / 521</i>

Neni 1 Lënda:

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

RREGULLIMI I TROTUARËVE NË VRELLË - Lot 1

Neni 2 Çmimi:

2.1 Çmimi total i punëve për aktivitetin e prokurimit
RREGULLIMI I TROTUARËVE NË VRELLË - Lot 2

është: 21.674,75 € dhe me fjalë:

/Njëzet e një mijë e gjashtë qind e shtatë dhjetë e katë euro 75/100 €

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës:

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

Plani për menaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet:

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për

pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut

Për Kontraktorin:
"V-SHALA" Sh.p.k

Emri: <i>pej</i> Zizë Bujupaj	Emri: Sadri Shala
Pozita: Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit	Pozita: D r e j t o r
Nënshkrimi: 	Nënshkrimi: 
Data: 19.08.2020	Data: 19.08.2020
Vu la 	V u l a 

KOMUNA E ISTOGUT					
NDËRTIMI I TROTUARËVE NË ZONËN URBANE NË VRELLË					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
Nr:	Specifikimi i punëve	Njësia	Sasia	Cmimi/ Njesi	Gjithsejt
Kubëzimi i Trotuarëve në Vrellë					
1 PUNËT PËRGADITORE					
1.1	Mobilizimi i ndermarjes dhe rregullimi i punishtes për punë si dhe largimi i instalimeve eventuale në punishte.	m'	925.00	0.10 €	92.50 €
1.2	Vendosja e shenjave të perkohshme vertikale dhe shenjave për siguri në trafik gjatë kryerjes së punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjatë punimeve.	m'	925.00	0.10 €	92.50 €
1.3	Shenimi i trasese si dhe percjellja e punimeve gjeodezike gjatë egzekutimit.	m ²	1,375.00	0.10 €	137.50 €
1.4	Demolimi: betoni, thyerja e tij me hilt (komprosor) dhe largimi deri në deponi (të parashihen edhe punët e paparapara në këtë pozicion gjatë thyerjes së betonit).	m ³	387.00	0.50 €	193.50 €
Totali 1:					516.00 €
2 PUNËT TOKSORE					
2.1	Gërmimi i dheut të kategori se IV dhe V me eskavator me trashësi t=25-30cm, dhe bartja e materialit deri në vendin e caktuar nga organi mbikëqyres.	m ³	412.50	1.00 €	412.50 €
2.2	Nivelizimi dhe ngjeshja e nënbazës së trupit të trotuarit me cilindër vibrues me ngjeshje adekuatë.	m ²	1,375.00	0.10 €	137.50 €
Totali 2:					550.00 €
3 PUNËT E ZHAVORIT					
3.1	Furnizimi, transporti, shtruarja dhe ngjeshja e zhavorit nga guri i thyer gelqeror 0-63mm me trashësi prej t=15-20cm në pjesën e trotuarit, ngjeshja të bëhet me cilindër vibrues deri në modulën e ngjeshjes së normativave.	m ³	275.00	4.00 €	1,100.00 €
3.2	Furnizimi, transporti, shtruarja dhe ngjeshja e zhavorit nga guri i thyer gelqeror 0-32mm me trashësi pas ngjeshjes t=10-15cm në pjesën e trotuarit, ngjeshja të bëhet me cilindër vibrues deri në modulën e ngjeshjes së normativave.	m ³	206.25	7.00 €	1,443.75 €
Totali 3:					2,543.75 €
4 PUNËT E SKAJOREVE DHE KUBZAVE					
4.1	Furnizimi me material dhe vendosja e gureve skajor prej betoni për kufizimin e kubzave sipas projektit me dimensione 18x25x100cm në bazament prej betoni me trashësi prej 15cm gjithnjë sipas rregulloreve.	m'	575.00	6.00 €	3,450.00 €
4.2	Furnizimi me material dhe vendosja e gureve skajor prej betoni për kufizimin e kubzave sipas projektit me dimensione 20x14x50cm në bazament prej betoni me trashësi prej 15cm gjithnjë sipas rregulloreve.	m'	350.00	3.00 €	1,050.00 €
4.3	Furnizimi me material dhe vendosja e gureve skajor prej betoni për kufizimin e kubzave sipas projektit me dimensione 8x20x100cm në bazament prej betoni me trashësi prej 15cm gjithnjë sipas rregulloreve.	m'	925.00	4.00 €	3,700.00 €
4.4	Furnizimi transporti dhe montimi i kubzave prej betoni të klases C-35/45 me trashësi t=6cm, në çmim të llogaritet edhe furnizimi dhe shtruarja e reres me fraksion (0-8mm) me trashësi t=5cm si dhe mbushja e fugave me rere, gjithnjë sipas rregulloreve EN 1338 duke përfshirë edhe zgjerimet dhe kyqjet në trotuar. Pë formën dhe modelin i kubzave të konsultohet organi mbikëqyres dhe Investitori.	m ²	1,375.00	6.50 €	8,937.50 €



4.5	Marja e mostrave për shqyrtim nga nje laborator i caktuar nga organi kontraktues ne vendet e caktuara te perzgjedhur nga organi mbikqyrës.	copë	3.00	20.00 €	60.00 €
			Totali 4:		17,197.50 €
5	PUNËT E PUSËTAVE DHE ATYRE TË PAPANAPARA				
5.1	Ngritja, pastrimi dhe nivelizimi i pusetave. Blerja dhe vendosja e kapakëve prej çeliku.	copë	9.00	45.00 €	405.00 €
5.2	Punët e papapara gjatë ekzekutimit të llogariten (pusetat qe nuk shihen, hidroinstalimet, instalimet e rrymës dhe punët përcjellëse).	m'	925.00	0.10 €	92.50 €
			Totali 5:		497.50 €
6	PËRFUNDIMI DHE PASTRIMI I PUNISHTES				
6.1	Pastrimi i punishtes pas përfundimit dhe mbushja e bankinave, d=80-100cm me zhavor nga guri i thyer gelqeror 0-32mm me trashesi pas ngjeshjes t=10-15cm dhe ngjeshja e tijë.	m ²	925.00	0.40 €	370.00 €
			Totali 5:		370.00 €
REKAPITULIMI					
1	PUNËT PËRGADITORE				516.00 €
2	PUNËT TOKSORE				550.00 €
3	PUNËT E ZHAVORIT				2,543.75 €
4	PUNËT E SKAJOREVE DHE KUBZAVE				17,197.50 €
5	PUNËT E PUSËTAVE DHE ATYRE TË PAPANAPARA				497.50 €
6	PËRFUNDIMI DHE PASTRIMI I PUNISHTES				370.00 €
				TOTALI ME TVSH	21,674.75 €

